



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:111882

Datë: 02.09.2024

Numri i dokumentit: 06189166

KA.nr. 659/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “Restorant BAE Rio” ShPK me NUI 811477810 me seli në magjistralen Ferizaj-Prishtinë në Ferizaj, kundër të paditurit Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, Inspektorati i Punës, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 08.08.202, në të cilën nuk mori pjesë asnjëra palë, më 2 shtator 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “Restorant BAE Rio” ShPK me NUI 811477810 kundër të paditurit Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, Inspektorati i Punës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr.685/2021 të datës 26.03.2021 i së paditurit.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 07.06.2021 kundër të Paditurit e ka iniciuar konfliktin administrativ, me kërkesën për anulimin e aktit administrativ nr.685/2021 të datës 26.03.2021 i së Paditurit.
2. Ai në padi ka pretenduar se më datën 11.11.2020 rreth orës 19:00 kanë pasur një inspektim nga Inspektorët e Punës në bashkëpunim me njësinë për hetimin e trafikimit me qenie njerëzore, inspektorët e tjerë të ATK-së dhe inspektorë komunal, të cilët kanë shqiptuar gjobë në shumë prej 5,000.00 euro me arsyetim se kinse 6 punëtorë shtetas të Republikës së Shqipërisë si dhe një punonjës nga Kosova kanë qenë duke punuar pa leje qëndrimi në Kosovë. Më tutje ka sqaruar se, vendimin e shkallës së parë e ka goditur me ankesë, ndërsa ankesën Inspektorati i Punës e ka refuzuar si të pa bazuar duke e vërtetuar vendimin e organit të shkallës së parë të Inspektoratit të Punës. Sipas tij Inspektorati i

Punës ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike sepse të gjithë personat të cekur në vendim përmes të cilit është shqiptuar gjoba administrative, nuk kanë qenë punonjës. Ka shtuar se një fakt i tillë nuk mund të dëshmohet sepse nuk mund të dëshmohen me dokumente myshterinjtë. Në seancën e shqyrtimit kryesor nuk mori pjesë, ndonëse ishte ftuar në mënyrë të rregullt.

3. I Padituri në përgjigje e tij në padi ka deklaruar se më datë 11.11.2020 te Paditësi kanë bërë inspektim, në të cilin kishin hasur punëtorë për të cilët nuk janë prezantuar leje qëndrimi, ndërsa Paditësi i ishte lënë kohë që të përmirësoj mangësitë e evidentuara nga Inspektorati i Punës. Sipas tij, Paditësi nuk kishte prezantuar asnjë dokument për punëtorët pa leje qëndrimi, andaj ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr. 04/L-219 për të Huaj, sepse ai ka punësuar persona në mënyrë të kundërligjshme. Ka theksua se vendimet e atakuar janë profesionale dhe konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi, ndërsa Paditësi pretendimet e saj nuk i ka vërtetuar me asnjë provë të vetme. Në seancën e shqyrtimit kryesor nuk mori pjesë, ndonëse ishte ftuar në mënyrë të rregullt.

II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

4. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: vendimi me numër të protokollit IP 685/2021 të datës 26.03.2021 të Organit të Shkallës së Dytë të Inspektoratit të Punës; vendimi mbi shqiptimin e gjobës me numër të protokollit 590/2020 i datës 29.12.2020 i Inspektoratit të Punës; si dhe shkresat e lëndës administrative të dorëzuara nga i padituri përmes përgjigjes në padi.
5. Gjykata pas analizimit të provat të cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat e të provuarit nga neni 322 i LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së e konstatoi gjendjen faktike të përshkruar më poshtë.
4. Inspektorati i Punës përmes inspektorëve të autorizuar në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe inspektorët e ATK-së, më datë 11.11.2020 rreth në orës 18:38 kanë ushtruar kontrollin e inspektimit te Paditësi, gjatë të cilit kanë konstatuar se kanë qenë duke punuar punëtorë shtetas të Republikës së Shqipërisë, në mesin e të cilëve disa ishin pa leje qëndrimi. Përmes procesverbalit ishte obliguar që brenda tre ditëve të dorëzoj kontrata të punës, leje qëndrimin, dëshmi për pagesa mujore, dëshmi për pagesën e kontributeve

pensionale, vendimet për shfrytëzimin e pushimeve vjetor për punëtorët e huaja. Këtë fakt gjykata e konsistoi përmes raportit zyrtar nr. 549/2020 të datës 11.11.2020, si pjesë e shkresave të lëndës administrative.

5. Më datë 19.11.2020 Inspektorët e Punës kanë realizuar vizitë ri inspektuese te Padiësi, të cilët kanë konstatuar se ai ka prezantuar dokumentet kontratat e punës për disa të punësuar, ndërsa nuk ka prezantuar leje qëndrimet për të punësuarit e huaj me inicialet D.C, Z.D, M.XH, rrjedhimisht ka vepruar në kundërshtim me nenin 67 par. 1 të Ligjit nr. 04/L-219 për të Huaj. Padiësi nuk ishte pajtuar me atë konstatim, duke shtuar se punën e ka filluar dy ditë para inspektimit, ndërsa punëtorja që nuk ka qenë në rregull e ka pasur natën e parë. Këto fakte gjykata i vetëtoi përmes raportit zyrtar 559/2020 të datës 19.11.2020, pjesë e shkresave të lëndës administrative
6. Inspektorati i Punës, si organ administrativ i shkallës së parë, përmes vendimit me nr. 590/2020 të datës 29.12.2020 Padiësit i ka shqiptuar gjobë në shumë prej 5,000.00€ për mos zbatim të dispozitës ligjore të nenit 67 para.1 e sanksionuar me nenin 132 par.2 të Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes vendimit të sapo cekur.
7. Kundër vendimit të shkallës së parë, Padiësi më datë 21.01.2021 ka parashtruar ankesë, të cilën Organi i Shkallës së Dytë i Inspektoratit të Punës përmes vendimit me nr.685/2021 të datës 26.03.2021 e ka refuzuar si të pa bazuar në ligj dhe e ka vërtetuar vendimin e shkallës së parë. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes vendimit të sapo cekur.

III. Vlerësimi meritor i rastit

8. Gjykata pas i mori parasysh të gjitha pretendimet e ndërgjyqësve, gjendjen faktike të konstatuar, si dhe pas analizimit të dispozitave juridike të shqyrtuara më poshtë, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e Padiësit është e pabazuar në ligj, rrjedhimisht kërkesëpadia e Padiësit duhet të refuzohet
9. Në rend të parë, gjykata gjen se procedura administrative që i ka paraprirë aktit administrativ të goditur është zbatuar në përputhje me LPPA-në. Gjithashtu, gjykata vë në pah se vendimi i goditur është i hartuar sipas nenit 47, 48 dhe 134 të LPPA-së. Për më tepër, gjykata gjen se i Padiuri është kompetent për zhvillimin e procedurës administrative dhe nxjerrjen e vendimit të goditur.

10. Përveç kësaj, gjykata konstaton se i Padituri i ka konstatuar të gjitha faktet relevante lidhur me rastin, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë në kuptim të gjendjes faktike lidhur me shkeljet e konstatuara. Në këtë drejtim, gjykata vjen në përfundim se Paditësi nuk e ka vërtetuar se personat me inicialet D.C, Z.D, M.XH nuk kanë qenë punëtorë të tij, ose ata persona kanë pasur leje pune. Në rend të parë, meqenëse Paditësi ka pretenduar se personat e cekur më lartë nuk kanë qenë të punësuar te ai por vetëm klient të tij, atëherë në bazë të nenit 322 para. 2 të LPK-së e ka pasur barrën e provës për ta vërtetuar pretendimin e tij.
11. Në anën tjetër, Paditësi nuk kishte paraqitur asnjë vërejtje ose sqarim të natyrës së tillë gjatë inspektimit të datës 11.11.2021 kur i Padituri kishte konstatuar se ata persona janë të huaj dhe janë duke punuar për Paditësin. Gjithashtu, edhe nga vërejtja e Paditësit, e dhënë në raportin zyrtar 559/2020 të datës 19.11.2020 se “...puntorja që ska qenë rregull ka qenë nata e par që ka fillu”, rrjedh se ai atë person e ka cilësuar si punëtorë. Në këtë drejtim, gjykata e gjen të pabazuar pretendimin e Paditësit ata persona kanë qenë klient, ndërsa nuk me asnjë dokument nuk mund të vërtetohet fakti se ata kanë qenë klient, meqenëse secilin nga ata persona ka mund t’i propozoj që të dëgjohen si dëshmitar në procedurën administrative. Pra, Paditësi si në procedurën administrative, por edhe në këtë konflikt administrativ, ka pasur në dispozicion mjete provuese për ta vërtetuar pretendimin e tij se, ata persona kanë qenë klient e jo punëtor.
12. Për këto arsye, gjykata duke i zbatuar rregullat lidhur me barrën e provës sipas nenit 322 të LPK-së vjen në përfundim se personat e cekur më lartë kanë qenë shtetar të huaj dhe Paditësi kishte krijuar marrëdhënien pune me ata, ndonëse nuk kishin leje të punës e as vërtetim për lajmërim në punë.
13. Përveç kësaj, gjykata vlerëson se i Padituri në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale administrative. Sipas nenit 67 para. 1 të Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt, i ndryshuar me ligjin nr. 06/L -036, ka përcaktuar se “*I huaji në Republikën e Kosovës mund të punojë në bazë të lejes së dhënë për qëndrim dhe punë ose vërtetimit për lajmërimin e punës, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe*”. Gjithashtu, neni 132 para. 1 nënpara. 1.1 i po të njëjtit ligj ka sanksionuar se “*Nga Inspektorati i Punës me gjobë në shumë prej pesëmijë (5.000) deri tetëmijë (8.000) euro për çdo të huaji do të dënohet punëdhënësi - një person fizik i cili e ka punësuar një të huaj ose e përdor punën e tij, dhe me gjobë në shumën prej njëzetmijë (20.000) në dyzetmijë (40.000) euro për çdo të huaj do të dënohet punëdhënësi - një person juridik i cili ka punësuar një të*

huaj ose e përdor punën e tij: 1.1. nëse e punëson një të huaj i cili nuk posedon lejeqëndrim për punë ose certifikatë të regjistrimit të punës (neni 67, paragrafi 1. i këtij ligji)”. Siç rrjedh nga këto dispozita, asnjë punëdhënës si person juridik nuk mund të krijoj marrëdhënies të punës me persona të huaj, përderisa këta të fundit nuk kanë leje pune, ndërsa nëse e krijon marrëdhënien e tillë të punës, atëherë ai do të gjobitet nga 20.000€ deri 50.000€. Megjithatë, Padiësi gabimisht është gjobitur si person fizik, rrjedhimisht është gjobitur me minimumin e gjobës së paraparë për persona fizik. Pra, i Padituri e ka shkelur ligjin material në favor të Padiësit.

14. Prandaj, meqenëse procedura që i ka paraprirë nxjerrjes së aktit administrativ të goditur është zbatuar në tërësi sipas rregullave të procedurës administrative, duke qenë se akti administrativ i goditur është dhënë në përputhje me nenet 47, 48 dhe 134 të LPPA-së, duke marrë parasysh se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike, siç është sqaruar edhe në pjesën e gjendjes faktike në këtë arsyetim, gjykata vjen në përfundim se nuk është plotësuar asnjë kusht ligjore nga nenit 52 i LPPA ose nenit 16 i LKA për anulimin e aktit administrativ të goditur, rrjedhimisht e refuzoi kërkesëpadinë e Padiësit për anulimin e aktit administrativ të goditur.
15. Për arsyet e cekura më lartë, gjykata duke u bazuar në nenet 13, para. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.659/22

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.